

Tëshikosh dhe të kuptosh sinjalet e lopës

Përgatitur nga Joep Driessen, mjek veteriner hollandez, duke referuar në Austri.

Në kullota lopët sillen në mënyrë të natyrshme: hanë, përtypen, vijnë rrotull dhe shtrihen lehtësisht. Tendenca e viteve të fundit është mbajtja 100% e lopëve në regjim stallor gjatë gjithë vitit. "Nuk është çudinëse fermeri e humbet vëmendjen ndaj sjelljeve normale të lopës"- sqaron Dr. Joep Driessen, mjeku veteriner hollandez. Gjatë seminareve ai shpreh në mënyrë praktike se si të vëzhgojmë në mënyrë të vetëdijshme lopët dhe si të vërejmë të ashtuquajturat sinjalet e lopës. Në artikullin e mëposhtëm përmbledhen pikat kryesore të referatit të tij.

Çfarë janë sinjalet e lopës?

Sinjalet e lopës mund të vihen re vetëm nëse kalon mjaftueshëm kohë duke vëzhguar sjelljen e tyre. Lopët gjatë gjithë kohës dërgojnë sinjale për gjendjen dhe shëndetin e tyre. Një shembull: Lopa, që qëndron një gjysmë ore në shtrat, ka frikë të shtrihet dhe më vonë të ngrihet përsëri. Ajo e di se nëse ngrihet do të marrë një goditje në shpinë nga mbajtësja e qafës. Lopa që qëndron në këmbë sinjalizon fermerin për ta vendosur ndryshe mbajtësen e qafës.

Një shembull tjetër: Nëse një lopë qëndron pranë hyrjes dhe pret do të thotë që ajo do të hajë, do të pijë ujë, do të shkojë në shtratin e saj, por nuk ka mjaftueshëm vend për të. Ose disa gunga në supet e lopës sinjalizojnë se grazhdi është montuar në mënyrë të gabuar. Fermerët duhet të vëzhgojnë dhe të kuptojnë këto sinjale, në mënyrë të tillë që të reagojnë me masa konkrete. Shpesh mungesa e njohurive dhe mënyra rutinë e të punuarit përbën një pengesë në këtë aspekt. Shpesh ndihmojnë dhe masa të thjeshta, jo domosdoshmërisht duhet një stallë e re.

Vetëm lopët, të cilat janë të shëndetshme dhe ndjehen mirë, kanë prodhim optimal. Kush i mban në vëzhgim lopët, mund t'i zbulojë herët sëmundjet dhe faktorët e rrezikut, përparase atotë kenë pasoja të rënda. "Gjithmonë duhet të kemi parasysh se përmirësimi i rehatisë së

lopës sipsh. më shumë dritë dhe ajërtë pastër në stallë, ka një ndikim pozitiv te fermeri. Puna në stallë bëhet më argëtuese!", shprehet veterineri.

Nga tufa në lopë të veçuar

"Si fillim duhet të vëzhgojmë, pastaj të mendojmë dhe në fund të veprojmë siç duhet. Ajo që vëzhgojmë duhet të vlerësohet siç duhet". Ju duhet gjithmonë të jeni të vëmendshëm ndaj detajeve të dukshme, por gjithashtu dhe ndaj lëvizjeve të qëllimshme (nëse lopa do të bëjë diçka, por nuk mundet) dhe ndaj rreziqeve. Gjithmonë duhet të veprohet në të njëjtën mënyrë: Kur futemi në stallë, fillimisht i hidhet një vështrim tufës. Si janë ndarë lopët në shtretër dhe në grazhdet e ushqimit, sa lopë qëndrojnë në këmbë, sa janë shtrirë, apo cilat vende janë të zëna, cilat të lira? Në këtë mënyrë marrim informacione të nevojshme përgjendjen e tufës. Lopët, që qëndrojnë në fund shmanjin kalimet në stallë dhe hanë vetëm atëherë, nëse janë ushqimete preferuara të tyre. Fatkeqsisht ato gjejnë ushqim më pak të mirë dhe shpesh bëhet fjalë për lopë të reja, të cilat sapo i janë bashkangjitur tufës. Nëse disa shtretër qëndrojnë gjithmonë bosh, kjo mund të jetë për shkak të ajrosjes së keqe si p.sh. në rastet kur fryn erë. Shkaqe të tjera si përmasat e papërshtatshme të vendeve ose një vend qëndrimi i keq bëjnë që të qëndrojnë pak lopë. Një lopë, pak rëndësi ka nëse është në një stallë kumund të lëvizë lirshëm ose në një stallë ku e ka të fiksuar vendin e vet, duhet të hajë 10 herë në ditë, pastaj të pijë dhe pastaj të shtrihet për të ripërlytur. Bëhet fjalë për një kohë ngrënie deri në nëntë orë dhe për një kohë ripërlytje deri në dhjetë orë. E rëndësishme është që lopët të shtrihen pa problem dhe të mund të çohen përsëri, kjo është e mundur vetëm nëse shtrati është mjaftueshëm i madh. Gjatë ndërtimit të shtratit duhet të merret parasysh që përmasat e lopëve Holstein janë rritur me 12 cm në dhjetë vitet e fundit.


Të vëzhgojmë lopët gjatë kohës që qëndrojnë dhe gjatë kohës që lëvizin

Mjeku veteriner rekomandon të ndjekim këtë mënyrë: pasi kemi hedhur një vështrim të përgjithshëm mbi tufën dhe stallën, hapi i dytë vijon me vëzhgimin e lëvizjeve të lopëve një nga një. Si ecën lopa, si mund të lëvizë në dyshtet e stallës? "Normalisht lopët ecin me shpinën drejtë, me hap të sigurtë, ato vendosin thundrat e pasme në gjurmët e thundrave të para" - thotë veterineri. Te lopët që qëndrojnë në këmbë ose te ato që rrinë shtrirë ai vëzhgon në vijim

kushtet e të ushqyerit, shkëlqimin e qimeve të lopës, njollosjet, plagët në shpinë, këmbët e pasme ose kyçat e këmbës. Kur këto probleme shfaqen në shumë lopë ato tregojnë kushte të këqija strehimi. Në shumë pak raste stallat janë ndërtuar duke marrë parasysh nevojat e lopëve, edhe pse ndërtuesit e stallave tashmë kanë një përvojë 30 vjeçare. Arsyeja qëndron te fermerët, të cilët duhet të bëjnë planifikimin dhe të jenë të vëmendshëm ndaj detajeve. Ata i përcaktojnë vetë përmasat e lopëve të tyre.

Cilat janë gabimet më të shpeshta?

Në 90% të fermave që ne kemi vizituar kemi konstatuar: Ushqimi duhet ndryshuar më shpesh. Më e mira do të ishte 6 herë në ditë! Kafshët kanë nevojë për më shumë enë për ujë. Më e mira do të ishte enë më të vogla për 12 lopë me rrjedhje të bollshme uji (20 litër në minutë). Në çdo cep të stallës duhet të ketë ujë në dispozicion. Shumica e stallave janë tepër të errëta. Lopët kanë nevojë për 16-18 orë dritë në ditë, për të pasur ecuri optimale. Dr. Driessen llogarit një llambë neoni për dy lopë. Kështu arrihet sasia e dritës e domosdoshme 150 lux për rezultat optimal dhe për mirëqenien e fermerëve dhe lopëve. Stalla duhet të jetë kudo e ndriçuar aq sa mund të lexohet gazeta me lehtësi! Lopët kanë nevojë për shumë ajër të pastër në stallë. Nëse do të hiqni muret anësore dhe çatia të jetë rreth 1 metër e lartë, atëherë keni për të vënë re një përmirësim të dukshëm. Në anën që preket nga kushtet ekstreme të motit duhet të ndërtohet një perde mbrojtëse për lopët. Pothuajse gjithmonë ka mangësi në shtratet e lopëve. Veterineri rekomandon vende me shtrat të butë, të lehtë dhe me shumë hapësirë në pjesën e kokës për të lëvizur në momentin kur çohet lopa. Është gjithashtu e rëndësishme që toka të ashpërsohet rregullisht me makinë prerëse për diamante, me qëllim që lopët të ecin të sigurt. Grafiku "Sinjalet e lopës- Diamant" (shiko grafikun më lartë djathtas) tregon në mënyrë të përmbledhur, se cilat nevoja duhet t'i plotësohen gjithmonë lopës dhe çfarë duhet të kemi parasysh në stallë.



Grafiku në formë diamanti "Sinjalet e lopës" tregon se cilat nevoja duhet t'i plotësohen lopës